



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: Agroekonomi

Programi: Ekonomia e Bujqësisë dhe ushqimit

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja **Bsc. Leonart Gashi** ,
me titull: “Analiza ekonomike e mbarështimit të demave për majmëri në Regjionin e Prizrenit ”

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 12.07.2024 deri me datë _19.07.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Asoc. Dr. Mustafë Pllana , kryetar,
2. Prof. Dr. Arben Musliu , mentor - anëtar,
3. Prof. Dr. Ragip Pllana , anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Dr. Arben Musliu përmes e-mail adresës:
arben.musliu@uni-pr.edu .

Për të pasur një informacion paraparak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë !

ABSTRAKT

Qëllimi kryesor i kësaj teme ishte analiza ekonomike e rritjes së demave të majmërisë në regjionin e Prizrenit. Ky studim dhe hulumtim është shtrirë në territorin e regjionit të Prizrenit duke përfshirë 3 komunitet (Prizren, Suharekë, Mamushë) dhe ka përfshirë gjithsej 50 ferma që mbarësjellin demat e majmërisë. Mbledhja e të dhënave primare është realizuar përmes pyetësorit, me anë të të cilit janë realizuar intervista direkte me fermerët. Të dhënat janë mbledhur për një periudhë 3 vjeçare 2017-2020. Këto të dhëna u analizuan përmes programit SPSS. Në këtë punim janë vlerësuar dhe analizuar dy sistemet e rritjes së demave të majmërisë në sistem të lidhur dhe në sistem të lirë në ambient të mbyllur duke e vërtetuar se cili sistem ka më shumë të mira ekonomike dhe përfitime si dhe avantazhet dhe disavantazhet e këtyre dy sistemeve, faktorët kryesorë që ndikojnë në përparësitë e njërit sistem se tjetrit e shumë analiza dhe krahasime lidhur me rendisin ekonomik dhe ndikimin e mbarështimit të demave të majmërisë në regjionin e Prizrenit, disa statistika përshkruese, korelacioni midis dy sistemeve të rritjes dhe disa faktorëve, gjithashtu janë bërë disa analiza të regresionit, analiza me chi-square test, independent sample t-test, binary logistic etj. Në bazë të këtij hulumtimi është vlerësuar se shumica e fermerëve mbajnë shënime në fermë. Sa i përket leverdis ekonomike të rritjes së demave të majmërisë në sistem të lidhur apo atë të lirë, nga fermerët nuk kanë pasur informacion dhe vërtetim se sistemi i lirë sjell më shumë të ardhura ka më shumë leverdi ekonomike si dhe rritja është më e lehtë e demave duke reduktuar punën në fermë gjatë mbarështimit, kurse përkundër faktit që fermerët kishin përvojë të konsiderueshme në fermat me dema, përvoja nuk doli të jetë statistikiqisht e rëndësishme, gjithashtu kjo vlen edhe për shkollimin, mbajtjen e shënimeve, komunën etj, që nuk dolën të rëndësishme statistikiqisht. Mbajtja e shënimeve ishte e lidhur me shkollimin e fermerëve do të thotë sa më i lartë shkollimi i tyre mbajtja e shënimeve rritet dhe në fund mund të themi se përfitimet ekonomike nga sistemi i lirë në ambient të mbyllur të demave të majmërisë janë më të larta në krahasim me sistemin e lidhur për fermat në regjionin e Prizrenit respektivisht fermerët e demave në Kosovë.

Majmëria e viçave luan një rol shumë të rëndësishëm në zbutjen e varfërisë në rajonet rurale të Kosovës. Testi Propensity score matchingn R studio është përdorur për të vlerësuar ndikimin e sistemeve të ndryshme të mbarështimit të fermave për majmërinë e viçave në të ardhurat bruto sezonale pas përputhjes së sistemeve të ndryshme të mbarështimit të fermave për majmërinë e viçave të vendosura në stallë me sistem të lirë ose të lidhur. Në total, 710 dema për majmëri në dy sisteme strehimit u monitoruan për 180 ditë. Gjetjet treguan se fermat për majmërinë e viçave që mbarësjellin demat e tyre në sistem të lirë të mbarështimit fitojnë mesatarisht 145.56 euro më shumë për dem të majmërisë për sezonin e rritjes në krahasim me fermat për majmërinë e viçave që mbarësjellin demat të vendosura në stallë me sistem të lidhur, $p < 0.009$. Studimi identifikoi shtimin e peshës ditore të viçit, numrin e demave në fermë dhe fitimet reale të fermës së viçave si variabla të rëndësishme që përputhen.

Fjalët kyçe: përfitimet ekonomike; sistemet; fermerët; Prizren